

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI I GJEOSHKENCAVE



Plani strategjik i zhvillimit

2018-2021

Nevojat dhe mundësit në Fakultetin e Gjeoshkencave

Gjeo-shkencëtarët e dekadave të ardhshme do të përballen me çështje lokale, nacionale dhe globale të ndërlidhura me zvogëlimin e resurseve minerale dhe energjetike, resurset ujore, rreziqet natyrore, si dhe vlerësimin e hapësirave për projekte infrastrukturore dhe zonave banuese. Përpjekjet e tyre duhet të ndërlidhen me sfidat mjedisore për të mbrojtur kualitetin jetësor, duke menaxhuar një zhvillim në një botë gjithnjë e më të populluar.

Fakulteti i Gjeoshkencave duhet të siguroj kuadro që kuptojnë proceset të cilat zhvillohen në Tokë dhe kanë aftësi për ofrim të zgjedhje të problemeve në mjedise pune ndër-diciplinare. Ata duhet të komunikojnë në mënyrë efektive me inxhinier, shkencëtar mjedisor dhe planifikues, dhe njëkohësisht duke edukuar publikun rreth lidhjeve në mes pjesës së ngurtë të Tokës dhe hidrosferës, atmosferës dhe biosferës së saj.

Strategjia e zhvillimit të vendit e bazuar në zhvillimin e resurseve minerale kërkon kuadro gjeologjike, të minierave dhe materiale/metalurgji, të cilat përveç njohurive në kërkim, zbulim, mihje dhe përpunim të resurseve, duhet të posedojnë edhe aftësitë e ballafaqimit me problemet e ndryshme mjedisore. Zhvillimi i planeve hapësinore, sigurimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve minerale, mbrojtja nga rreziqet natyrore dhe sigurimi i kushteve mjedisore janë segmente shumë të rëndësishme për vendin të cilat kërkojnë dorën e gjeo-shkencëtarëve. Nisur nga këto fakte, dhe jo vetëm, gjeo-shkencëtarët do të jenë një kuadër i kërkuar në rritje.

Misioni

Fakulteti i Gjeoshkencave aspiron për të siguruar arsim të lartë cilësor në shkencat e Tokës dhe teknikat dhe teknologjinë e mihjes dhe përpunimit të resurseve. Përmes metodave praktike të mësimin, hulumtimeve shkencore dhe praktikave të ndryshme në institucione dhe industri, studentët do të fitojnë aftësi të zbatueshme për karrierë në shkencat e Tokës dhe disiplina të ndërlidhura. Programet e Departamenteve, me theks në kuptimin e proceseve të sistemit Tokë dhe ndërlidhjet e tyre, sigurimin dhe procedimin e resurseve minerale në mënyrë të qëndrueshme, do tu mundësoj studentëve sigurimin e një perspektive globale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve, marrjen e vendimeve, dhe rolet udhëheqëse në një botë që po ndryshon me shpejtësi dhe po ballafaqohet me sfidat e mjedisit.

Fushat e interesit

Fushat e paraqitura më poshtë nënvizojnë rëndësinë globale të gjeo-shkencëtarëve të ardhshëm si ekspert teknik në zhvillimin dhe menaxhimin e resurseve të limituara të Tokës, lojtarë kyç në zbutjen e rreziqeve natyrore dhe kujdestar të praktikave të ndjeshme mjedisore.

1. Hulumtimi, shfrytëzimi dhe përpunimi i resurseve minerale

Ekonomia globale dhe popullsia po vazhdojnë të rriten duke shpie në kërkesa të papara për burimet minerale në botë, veçanërisht në vendet në zhvillim. Gjeoshkenctaret janë ata që posedojnë njohurit e nevojshme për të gjetur, vlerësuar, shfrytëzuar dhe përpunuar: ujëra nëntokësor, metale, minerale industriale dhe lëndë djegëse fosile. Hulumtimi i resurseve minerale, zhvillimi dhe menaxhimi tyre duhet të vazhdojë, nëse standardet e jetës në Tokë duhet të ruhen. Uji i freskët po bëhet po ashtu një mall i çmuar, ndërsa fokusi i kohës së fundit në energjinë diellore dhe makina elektrike po shton kërkesat për metale që gjejnë përdorim në qeliza fotovoltaike dhe bateri të rimbushura. Tradita dhe kuadrot e Departamenteve nga fusha të ndryshme të gjeologjisë, xehetarisë dhe materiale-metalurgji e vendosin FGJ në një pozitë të përshtatshme për nxjerrjen e të diplomuarave të kualifikuar për të adresuar këto çështje problematike. Tri fusha të rëndësishme të resurseve kërkojnë ekspertiza gjeoshkencore të ndërlihdura me ndërgjegjësimin mjedisor:

Metalet dhe Mineralet industriale

- Një nga sektorët në të cilët Kosova mbështet strategjinë zhvillimore janë resurset minerale.
- Zgjerimi i hulumtimeve të vendburimeve ekzistuese dhe hulumtimi i resurseve të reja të mineraleve metalore është një nga segmentet më të rëndësishme të zhvillimit të sektorit minerar.
- Marr parasysh zhvillimet e së kaluarës dhe trashëgimin e dëmeve mjedisore, zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit minerar dhe menaxhimi sipas praktikave më të mira të njohura do të duhej të ishin parakusht i këtyre zhvillimeve.
- Mineralet industrial si rëra, zhavorri, gëlqerorët dhe argjila përbëjnë lëndën e parë me rëndësi për industrinë e ndërtimitarisë dhe ndërtimin e rrugëve.
- Gjeologët me përvojë në hulumtime janë dhe do të jenë të kërkuar.
- Nevojat e mëdha të ekonomisë botërore për metale janë gjithnjë e më shumë në rritje. Kosova është e pasur me minerale si të Pb dhe Zn të percjellura me metale tjera dhe të çmuara, minerale të hekur – nikelit, boksitit etj, e që nga ky fakt rrjedh edhe qëllimi kryesor i planit strategjik të departamentit të jetë në ngritjen profesionale të studenteve për metodat e shfrytëzimit të resurseve minerale.

Resurset ujore

- Sigurimi i furnizimit të mjaftueshëm me ujë për përdorime shtëpiake, bujqësore dhe industriale është thelbësor për jetën e njeriut.
- Punë dhe karrierë si hidrogjeologë dhe hidrologë: hulumtimin dhe nxjerrjen e ujërave nëntokësor, monitorimin e cilësisë së ujit, planifikimin e burimeve të ujit, modelimin e ujërave nëntokësore, përdorimi i ujërave të ricikluara dhe trajtuara, trajtimi i ujërave të ndotura nëntokësore, etj.
- Përdorimi i pajisjeve moderne gjeofizike ofron një kosto efektive për hartografimin e cekët të Tokës dhe dëshmon për vetitë e saj fizike. Informacionet e rezultuara tre-dimensionale janë

vendimtare për eksplorim të ujërave nëntokësor, metale, si dhe vlerësimin e karakteristikave të themeleve/trojeve.

- Gjeologët/hidrogeologët duhet të punojë me agjencitë publike dhe private për të siguruar një furnizim të rregullt me ujë, menaxhimit të mirë dhe cilësi të sigurt të ujit.
- Menaxhimi i ujit do të jetë jetike për rritjen e ardhshme të Kosovës, ku pjesa perëndimore është e pasur me ujë, por pjesa qendrore dhe lindore ka resurse të limituara.
- Hidrogeologët mund të punojnë në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me biologë, kimistë, inxhinierë, planifikuesit dhe agjencitë rregullatorë qeveritare.

Resurset energjetike

- Kalimi në një shkallë globale nga lënda djegëse fosile në burime alternative energjetike (neutral për nga emetimi i Karbonit) pa dyshim do të marrë dekada. Prandaj prodhimi i naftës, gazit natyror dhe qymyrit do të vazhdojë të jetë një prioritet derisa teknologjitë alternative të energjisë të kenë fituar efikasitet dhe të jenë me kosto efektive.
- Duke punuar në bashkëpunim me krijuesit e politikave në të gjitha nivelet qeveritare, gjeoshkençarët do të mund të ndihmojnë në krijimin e kursit më të mirë praktik për eksplorimin e ardhshme të energjisë.

2. Analiza të rreziqeve natyrore dhe masat lehtësuese

Një masë e madhe e njerëzimit sot jetojnë në zona me potencial të lartë të rreziqeve natyrore. Rritja e dendësisë së popullatës dhe ndërtimeve ka shtuar kërcënimin nga rreziqet natyrore në Kosovë, para së gjithash nga tërmetet, vërshimet dhe rrëshqitjet e tokave. Kjo po shpie në ngritjen e kostos mesatare të dëmeve në prona dhe jetën e njerëzve. Gjeoshkençarët jo vetëm bëjnë identifikimin, monitorimin dhe vlerësojnë këto rreziqe, por po ashtu punojnë afër me inxhinier. Agjencione qeveritare dhe planifikues të qyteteve për të ndihmuar në zhvillimin e strategjive dhe teknologjive për të evituar humbjen e jetës së njerëzve dhe zbutur dëmet e pasurisë.

Zhvillimi i Infrastrukturës dhe Vendbanimeve

- Siç është cekur më sipër, Kosova është e rrezikuar para së gjithash nga tërmetet, rrëshqitjet dhe vërshimet. Gjeoshkençarët dhe inxhinierët me trajnime gjeologjike mund të ndihmojnë në vlerësimin e këtyre rreziqeve dhe rekomandimin e masave lehtësuese dhe parandaluese. Studimet sizmike sigurojnë informacione relevante për dizajnimin e ndërtesave të sigurta nga tërmete.

3. Kualiteti i mjedisit dhe ndryshimet klimatike globale

Për të kuptuar çështjet e sotme komplekse mjedisore kërkohet njohuri se si ndërvepron Toka e ngurtë me hidrosferën saj, atmosferën dhe biosferën; dmth, " Shkenca e sistemit Tokë". Në detyrën e një gjeoshkencëtari është të artikuloj shkencën prapa proceseve mjedisore. Ngrohja globale dhe ndryshimet klimatike janë bërë kohët e fundit terme shtëpiake. Shkencëtarët ofrojnë një perspektivë të rëndësishme kohore në studimet e tyre të luhatjeve globale klimatike të para-njerëzimit. Trajnimi i tyre

në Shkencën e Sistemit Tokë i bën ata ideal, këshilltarë jopartiake për politikë-bërësit. Departamenti i Shkencave Gjeologjike shtron nevojën e forcimit të bazës së saj rreth njohurive të shkencave mjedisore . Kjo kërkon laborator mjedisor dhe hidrogeologjik për tu ofruar studentëve përvojë në ndërveprimet ujë-tokë-shkëmb dhe proceset e vërshimeve.

- Prodhimi nga burimet natyrore dhe zhvillimi i tokës duhet të ndodhë me një përgjegjësi më të madhe në raport me mjedisin e Tokës. Gjeoshkenctarët luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin e karakteristikave të lokacionit dhe paraqitjen e vlerësimin e ndikimeve në mjedis.
- Kontaminimi I ujërave nëntokësor dhe sipërfaqësor është një çështje me rëndësi globale. Mësimet nga vendet e zhvilluara duhet marr për mos përsëritje të gabimeve të njëjta. Teknikat e suksesshme të zbutjeve dhe evitimit të ndikimeve në mjedis do të duhej të adoptoheshin.
- Çdo vit bota kërkon më shumë trajtim dhe deponim të mbeturinave. Sfidat janë të bëhet kjo në mënyrë efikase dhe duke siguruar ndikim minimal në ekosisteme dhe shëndet të njeriut.

Qëllimet strategjike

Qëllimi 1: Ngritje akademike nëpërmjet programeve bashkëkohore "Të mësojmë duke bërë"

Qëllimi 2: Përmirësimi i nivelit të studimeve

Qëllimi 3: Promovimi i Fakultit Gjeoshkencave, Misionin dhe rëndësinë e tij në vend

Qëllimi 4: Zhvillimi i marrëdhënieve të jashtme dhe mekanizmat përkrahës.

Qëllimi 5: Angazhimi në mbledhjen e fondeve akademike dhe marketingun.

Qëllimi 1: Ngritje akademike nëpërmjet programeve bashkëkohore

Objektivat	Strategjia	Indikatorët e suksesit
1.1. Zhvillimi i një kurrikule moderne me theks në fushat e zhvillimit strategjik.	a) Dizajni dhe zbatimi i programeve me theks në fushën e hulumtimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të resurseve minerale dhe resurseve ujore, ... b) Vazhdimi i rritjes përmes zhvillimit të fushave tjera c) Përcjellja e progresit të studentëve d) Përmirësimi i programeve nga aspekti i përdorimit të kompjuterëve.	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimet e aktualizuara të lëndëve dhe parakushteve tjera • Programet e aprovuara • Modifikimi i programeve në bazë të reagimit të studentëve • Numri i studentëve të diplomuar nga secila fushë • Shtimi i komponentëve kompjuterik në

		përshkrimin e lëndës
1.2. Rritja e aktivitetit akademik	Të zhvillojë një mekanizëm për vlerësimin e produktivitetit të Departamenteve në fakultetin me emërimin e një komisioni ad hoc për zhvillimin e procedurave të vlerësimit.	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i publikimeve. • Nivelini e financimit • Monitorimi • Mësimdhënie
1.3. Përmirësimi i studimeve nëpërmjet përdorimit të laboratorëve bashkëkohor dhe pajisjeve në terren.	<p>a) Sigurimi dhe mirëmbajtja e laboratorëve bashkëkohor dhe pajisjeve të punës në terren,</p> <p>b) Vërja e theksit në punët laboratorike dhe aktivitetet fushore në programe.</p> <p>c) Lehtësimi i qasjes së studentëve në laboratorë dhe aktivitete në terren</p> <p>..</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Blerja e pajisjeve për mësim dhe hulumtim • Kontratat e mirëmbajtjes • Lëndët e bazuara në punë laboratorike dhe punë terreni në program • Projekte dhe tema (Bachelor, Master) të bazuara në laborator dhe punë terreni • Automjete terreni dhe qasja në ato.
1.4. Zhvillimi i programeve të reja Master dhe programet e doktoraturës	<p>a) Zhvillimi i praktikave monitoruese të programeve ekzistuese dhe shqyrtimi i tyre</p> <p>b) Analizimi dhe vlerësimi i nevojave në vend për programe të reja</p> <p>b) Zhvillimi i politikave të Departamenteve për përpilimin e programeve të doktoratës</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i programeve të reja master • Programi i doktoraturës • Numër i studentëve që vazhdojnë të diplomojnë
1.5. Te ruaj dhe promovon fakultetin, stafin dhe profesionistët duke rritur dëshirën për punë për të gjithë të punësuarit,	<p>a) Gjetja e burimeve shtesë për personelin, dhe mbështetja e nevojshme për të kryer hulumtime, mësimdhënie dhe shërbime me cilësore</p> <p>b) Ofrimi i orientimit për punonjësit e rinj që qartë të artikulojnë pritjet e tyre.</p> <p>c) Puna për të gjetur fondet e duhura të udhëtimit për fakultetin dhe stafin.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mjetet e siguruar teknike dhe financiare. • Numri i stafit të përkrahur në hulumtime dhe udhëtime • Niveli i kënaqësisë së të punësuarve

Qëllimi 2: Përmirësimi i nivelit të studimeve

Objektivat	Strategjia	Indikatorët e suksesit
2.1. Promovimi i modeleve – stimulim/bursa për	a) Kërkesa për bashkëpunim hulumtimi me student-fakultet	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantimet e fakultetit dhe studenteve në

mësimdhënie	<p>b) Përkrahja e pjesëmarrjes së fakultetit dhe studentëve në konferenca shkencore</p> <p>c) Sigurimi i stimulimit për mentorët të cilët lidhin mësimdhënien me hulumtime</p> <p>d) Përmirësimi i përvojave të studentit në terren përmes udhëtimeve të udhëhequra nga fakulteti/mentorët në vende lokale, rajonale dhe ndërkombëtare</p>	<p>Konferenca</p> <ul style="list-style-type: none"> • Projekte të përfunduara • Teza Masteri të përfunduara • Ndarja e fondeve për udhëtime • Fonde për përkrahen e studentëve • Propozime të paraqitura për fonde për udhëtime/terrene regjionale dhe ndërkombëtare
2.2. Avancimi i mundësive hulumtuese dhe analitike përmes pajisjeve modern laboratorike dhe terreni	<p>a) Sigurimi dhe shfrytëzimi i pajisjeve të reja për mësimdhënie dhe kërkime</p> <p>b) Ngritja e laboratorëve dhe pajisjeve të punës në terren, si dhe teknologjinë kompjuterike në standarde të industrisë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Furnizimi me pajisje të reja • Aktivitetet laboratorike dhe në terren që përfshijnë studentët • Avancimi i softuerëve, kalibrimi i pajisjeve, kontratat e mirëmbajtjes
2.3. Përmirësimi i ambientit të mësimdhënies dhe mësimnxënies	<p>a) Sigurimi i mjeteve moderne për mësim</p> <p>b) Vlerësimi i rezultateve të mësimin dhe përmirësimi i vazhdueshëm në harmoni me strategjinë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Modernizmi i klasave të mësimin • Vlerësimi i mësimdhënies nga kolegët dhe studentët • Raporte periodike mbi vlerësimin e rezultateve të mësimin

Qëllimi 3: Promovimi i FGJ, Misionin dhe rëndësinë e tij në vend

Objektivat	Strategjia	Indikatorët e suksesit
3.1 Përfshirja e FGJ në hulumtime dhe ngjarje me rëndësi të drejtpërdrejt për shoqërinë	<p>a) Përmirësimi dhe ngritja e raporteve më institucionet tjera vendore</p> <p>b) përfshirja e studentëve në projekte dhe teza masteri me lidhje të drejtpërdrejt me industrinë lokale dhe çështje të komunitetit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kontratat dhe bursat/fondet nga institucionet • Projekte dhe tezat të masterit të bazuara në interesat dhe çështjet lokale
3.2. Ngritja e bashkëpunimit me fakultete dhe kolegje vendore	<p>a) Pjesëmarrje në ngjarje/simpoziume të përbashkëta</p> <p>b) Paraqitja e propozimeve për bashkëpunim</p> <p>c) Ftesa e studentëve të kolegjeve</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrja në Simpoziume • Propozimet e ofruara me involvim te FGJ • Fondet e pranuar nga

	dhe fakulteteve në organizmat e FGJ.	bashkëpunimi <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrja e studenteve në studime fushore/terrene
--	--------------------------------------	--

Qëllimi 4: Zhvillimi i marrëdhënieve të jashtme dhe mekanizmat përkrahës.

Objektivat	Strategjia	Indikatorët e suksesit
4.1 Lidhja e të diplomuarve me industrinë dhe punëdhënësit qeveritar	a) Mbajtja e bazës së të dhënave të punëdhënësve b) Njoftimi i studentëve mbi mundësit dhe vendet e punësimit dhe kryerjen e praktikave c) Organizmi i panairëve të punësimit; ftesa e menaxherëve të programeve dhe punëdhënësit në kampus d) Vendosija e shtigjeve për punësim dhe karrierë të diplomuarave në FGJ	Baza e të dhënave të punëdhënësve <ul style="list-style-type: none"> • Numri i studentëve që kanë aplikuar dhe pranuar në programe bashkëpunimi • Pjesëmarrja e të diplomuarave në panairë punësimi
4.2. Rritja e integritit të gjeoshkencave	a) identifikimi dhe reklamimi i kurse ndër-disiplinore. b)	<ul style="list-style-type: none"> • Numra të studentëve ndërdisiplinorë. • Numër i nxënësve ndërdisiplinor që vazhdojnë të diplomojnë.

Qëllimi 5: Angazhimi në mbledhjen e fondeve akademike dhe marketingun.

Objektivat	Strategjia	Indikatorët e suksesit
4.1 Rritja e fondeve për programet akademike, duke përfshirë bursat, anëtarësimet, profesorët,	a) Zhvillimi dhe zbatimi i një plani për shtrirjen e fondeve dhe ngritjen e fondeve për të diplomuarit. Koordinon me Zyrën e Zhvillimit. b) Vazhdimi i rritjes së theksit në takimet profesionale, c) zgjerimi i faqes se internetit për të postuar lajme dhe informacione të tjera.	<ul style="list-style-type: none"> • Mbledhja e donacioneve • industria dhe • Bashkëpunëtorët e gjeoshkences